



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1412/ 1 prot.,

Datë 03.06.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “CompiTel” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Ref-40796-03-11-2025, me objekt Blerje goma me fond limit 6,306,801 (gjashtë milion e treqind e gjashtë mijë e tetëqind e një) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 11-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik.

Ankimues:

Operatori ekonomik “CompiTel” shpk me NIPT M31417021V dhe adresë Bashkia Tirane, Rruga iFrosina Plaku, Njesia Administrative Nr.7, Zona Kadastrale 8220, Pallati S

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik, me adresë Rruga “5 Maji” , Tiranë”.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/1412, datë 02.06.2025 dhe me Nr.1412/2025 Prot., datë 02.06.2026 e operatorit ekonomik “CompiTel” shpk, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me- Ref-40796-03-11-2025, me objekt Blerje goma me fond limit 6,306,801 (gjashtë milion e treqind e gjashtë mijë e tetëqind e një) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 11-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “CompiTel” shpk, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”*, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “CompiTel” shpk.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit në lidhje me pikën si më poshtë vijon :

Operatori Ekonomik nuk permbush piken 3, Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient pune, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit të montimit të gomave, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:..... pasi OE ka paraqitur nje deklarata si dhe një akt-marrëveshje noteriale, me nr. Rep. 1585 dhe nr. Kol. 976, ku sherbimin për kryerjen e montimit të gomave do ta beje Shoqeria ALPA shpk me seli ne Lac.

KVO arsyeton si me poshtë : bazuar në parimin e efikasitetit dhe mirepërdorimit të fondeve publike, siç parashikohet në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), është e arsyeshme që shërbimet e mirëmbajtjes, përfshirë ndërrimin e gomave për automjetet në përdorim nga institucionet e Bashkisë Tiranë, të kryhen brenda qarkut të Bashkisë, për të garantuar:

- Koordinim të shpejtë dhe efikas të ndërhyrjeve, në rast të defekteve të papritura;
- Ulje të kostove operative, si transporti i mjeteve jashtë territorit të Bashkisë;
- Mbikëqyrje më të lehtë dhe monitorim të cilësisë së shërbimit nga vetë institucionet publike përkatëse;

- Operatori Ekonomik nuk permbush piken 6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike për të gjitha gomat, në formë table, ku të plotësohet: Emri i kompanisë prodhuese, Emërtimi i katalogut të artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Emërtimi i artikullit (kodi) nxjerrë nga manuali i prodhuesit, linku i produktit në Web-in e prodhuesit si dhe çertifikimet përkatëse për secilin produkt.....Pasi OE ka paraqitur oferten teknike por nuk eshte e firmosur dhe vulosur nga administratori i kompanise.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 03.06.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergji Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri